

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë dhe të nderuar qytetarë,

Do ta kisha kërkuar edhe unë fjalën për procedurë, zonja Kryetare, por ato dy minutat e procedurës, ju lutem, dhurojuani kolegëve të opozitës që të shprehin mendimin për atë pikë, që ne kemi rënë dakord të jetë në rendin e ditës, të cilën po e diskutojmë: Konventa për Organizatën Ndërkombëtare të Ndhmës Detare në Lundrim. Po flasim për sigurinë detare të shqiptarëve dhe të të gjithëve miqve tanë, që lundrojnë në ujërat tona, ndërkohë që ju e morët rendin e ditës, e çuat në La Mansh, e hipët në gomone, ndërkohë që shqiptarët na paguajnë për të përmirësuar jetën e tyre. Kështu që ato dy minuta faluani atyre, që të flasin se çfarë mendimi kanë për sigurinë detare.

Zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Projekti i sotëm është jashtëzakonisht i rëndësishëm. U bënë 65 vjet që disa vende, të cilat e kuptojnë shumë mirë sigurinë detare, e kuptojnë shumë mirë se çfarë do të thotë të kesh një sistem lundrimi, u mblodhën së bashku dhe krijuan shoqatën ndërkombëtare të ndihmës detare në lundrim. Ju deshën 30 vjet që sistemet e ndryshme, që kishin shkaktuar edhe fatkeqësi të mëdha njerëzore, ku ishin përplasur anije e kishin humbur jetë njerëzish, të mund të standardizojnë një sistem dhe ai sistem të konsolidohet. Sot ne jo vetëm që e njohim këtë shoqatë, jo vetëm që Shqipërinë e bëjmë pjesë të kësaj shoqate dhe e ndihmojmë të aderohet në këtë shoqatë, por përfundojmë procesin e tranzicionit, pra që të kalojë nga një shoqatë jofitimprurëse ndërkombëtare, patjetër në një organizatë ndërqeveritare.

Të nderuar qytetarë, shumica, kjo qeveri sjell sot përpara jush një projekt jashtëzakonisht të rëndësishëm. Ne do të bëhemi pjesë e një aleance, ku siguria detare është në themel të saj. Ministri e tregoi qartë, IALA, siç shkruhet shkurtimisht kjo organizatë, ka një ekspertizë të paimagjinueshme për sa i përket sistemit detar të lundrimit dhe ne do të marrim nga kjo asistencë. Patjetër që shqiptarët kanë dalë herët në dete; patjetër që shqiptarët dhe flamuri ynë ka lundruar në detet ndërkombëtare, por sot po ndihmojmë edhe ekonominë e vendit tonë, sepse 65% e eksporteve dhe importeve vijnë përmes rrugëve detare, që do të thotë se brigjet tona dhe hapësira jonë detare do të jenë më të sigurta dhe të standardizuara.

Unë e kuptoj që sot ne jemi duke u marrë me një instrument shumë teknik, pra ekspertët e shoqatës në momentin që ne do të bëhemi anëtarë, do të na ndihmojnë që të kontrollojmë të gjithë sistemin e faro-fenerit, bovat, spirancat lundruese e kështu më radhë, në mënyrë që të jenë të sigurt të gjithë ata që lundrojnë në ujërat shqiptare. E kuptoj hallin e faro-fenerit të korrupsionit, që është në radhët e opozitës, i cili, për sa kohë do të sjellim marrëveshje, ku bëhemi pjesë e aleancave strategjike, do të përpiqet të bëjë zhurmë dhe të pengojë mirëqenien e begatinë e shqiptarëve.

Kjo ndodhë pikërisht në një moment, kur provuam katërçipërisht se vetëm si pjesë e aleancave strategjike mundemi t'u bëjmë ballë sfidave të këtij momenti, pra vetëm duke qenë pjesë e një aleance, siç është NATO-ja, ne mundëm të përballojmë një agresion, i cili në mediet ndërkombëtare ka marrë termin e agresionit global. Iranianët dalin në një agresion kibernetik global dhe sulmojnë një vend të NATO-s, pra i gjithë vendi ynë është ngritur në këmbë, për shkak se në fund të ditës ato nuk janë posta dhe email-i i Kryeministrit. Madje disa kolegë të papërgjegjshëm edhe fërkojnë barkun. Ndërkohë, bëhet fjalë për shërbimet e shqiptarëve.

Vetëm se jemi pjesë e një aleance me ekspertizën e duhur, e një aleance, që është në krahun e duhur, e një aleance me vlerat e duhura, ne mundëm t'i kthenim brenda ditës shërbimet dhe mundemi sot t'i sigurojmë qytetarët shqiptarë se janë më të mbrojtur, më të sigurt jo vetëm në hapësirën e tyre virtuale, por edhe në shërbimet e tyre ditaditës. Ndaj, edhe sot ju ftoj ta miratojmë konventën, këtë projektligj, që ne të bëhemi pjesë e kësaj aleance dhe bashkë me aleatët t'u ofrojmë qytetarëve tanë siguri në det. Gjithashtu, jam i sigurt se, siç miratuam javën

e kaluar projektin më të madh me Komisionin European, do t'u japim atyre siguri në familjet dhe shtëpitë e tyre. Ju falënderoj!